

REZISTENCA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR PUSHTUESVE SERBO-MALAZEZË 1912-1914

Në vazhden e Luftës së Parë Ballkanike, derisa ende nuk kishte hyrë ushtria serbe në Shkup, menjëherë pas Betejës së Kumanovës, në rrethinat e këtij qyteti paria shqiptare e Kosovës fillon organizimin e lëvizjes së rezistencës. Udhëheqësit shqiptarë të kryengritjeve të viteve 1910-1912 edhe tani, pas dështimit të Kryengritjes së vitit 1912, ishin aktivë në Luftën e Parë Ballkanike, u munduan që edhe me ato forca të shkapërderdhura t'u bënin rezistencë forcave ushtarake të Aleancës Ballkanike. Ushtria serbe që ndodhej në Karadakun e Shkupit informohet se paria shqiptare e Kosovës ndodhej në fshatin Brezë. Kjo informatë i dërgohet komandantit të Armatës I serbe, gjeneralit Mishiq, i cili kishte hyrë në Shkup.¹ Ai urdhëron ushtrinë që ndodhej në terrenin e përmendur të bastiste fshatrat, e sidomos Brezën, të kapte parinë shqiptare dhe ta sillte në Shkup. Aksioni i tyre serbe që i suksesshëm dhe të zënë pothuajse menjëherë u përcollën për në Beograd si robër lufte.²

Sipas një letre të parisë shqiptare dërguar nga Kështjella e Beogradit më 24.11.1912 kryetarit të Këshillit të Ministrave të Serbisë, Nikola Pašiqit, të burgosur ishin: Nexhip bej Draga nga Mitrovica, ish-deputet, Hasan bej Vuçitërna, ish-deputet, Hoxha Seit Efendia, nga Shkupi, Shaban Pasha nga Prishtina, Kemajl bej nga Shkupi, Hurshid bej nga Prishtina, Muharrem Efendia nga Prishtina, Xhemajl bej nga Prishtina, Hurshid bej nga Dobratini – Prishtinë, Jashar Pasha nga Peja, Ibrahim bej

¹ A.H.I.B. K-13, f – 1 nr. 1/16. Raporti i kryeshefit të Kumanovës i 3.11.1912, "Politika" 3.12.1912.

² Shih: Dr. Liman Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Prishtinë 1986 fq. 133-135.

Kokola nga Prishtina, Idriz Seferi nga Seferi, Gjilan, dhe Kasum Seferi nga Seferi, Gjilan.

Nga letra e nënshkruar prej të përmendurve kuptojmë se këta ishin zënë-arrestuar gjashtë pas pushtimit të Shkupit nga ushtria serbe. "Neve pa kurrfarë arsye, na sollën këtu në Kështjellën e Beogradit..."³ Pra, duke ditur ditën e okupimit të Shkupit të botuar në gazetën "Politika", del se këta persona janë arrestuar më 1 apo 2 nëntor 1912, ngase më 4 ndodheshin në Beograd. Prandaj, të gjitha manipulimet pse Hasan Prishtina ishte në Stamboll; pse nuk ishte në Vlorë më 28.11.1912, sqarohen dhe bien në ujë. Hasani nuk ka mundur të ndodhej në dy vende në të njëjtën kohë. Kjo pari qëndron e internuar në Kështjellën e Beogradit deri më 14 prill 1912, kur lirohen me propozimin e Këshillit Ministror Komandës III serbe që t'i lirojë të përmendurit,⁴ me kusht që këta të jenë qytetar lojalë të Serbisë.

Depërtimi i forcave ushtarake serbe në Kosovë u shoqërua me djegien e shkatërrimin e fshatrave të tëra dhe me vrasjen e grave, pleqëve e fëmijëve. Shqiptarët prore iu kundërvunë këtyre pushtuesve duke mos kursyer asgjë. Kështu, kur më 14-15 nëntor lufta filloi në frontin e Llapit në Merdare, Isa Boletini me shokë ndodhej në Kolesian të Lumës duke luftuar kundër ushtrisë serbe.⁵ Në Lumë, pra, ishte hapur fronti i luftës kundër ushtrisë serbe, e cila digjte të gjitha fshatrat që arrinte t'i pushtonte. Nga gjysma e nëntorit ushtrisë serbe në Lumë i shkojnë përforsime të mëdha të Armatës III nga Kosova e Maqedonia, prandaj shqiptarët e vetorganizuar u detyruan të tërhiqen në drejtim të brigjeve të Drinit të Bardhë dhe të malit Koritnik. Gjenerali i Armatës III serbe iu bëri thirrje lumjanëve të dorëzohen, ngase nuk do të kenë qetësi derisa: a) Paria dhe hoxhallarët nuk vijnë në bisedime; b) të dorëzohen armët nga popullata nëse dëshirojnë të jetojnë në rehati; c) popullata e Lumës t'i çarmatosë kosovarët e ardhur nga viset e ndryshme të Kosovës dhe t'i dorëzojnë ose të tregojnë se ku gjendeshin Isa Boletini, Ramadan Zaskoci, Riza beu, Islam Spahiu nga Kolesiani, dhe Bajram Daklani. Ushtria serbe kërkoi po ashtu që paria e Lumës t'i prijë ushtrisë serbe nëpër fshatra dhe ta informoj për Lëvizjen e rezistencës; që nga çdo fshat të jepen nga 5 njerëz të parisë si peng dhe të dërgohen në Prizren. Nëse këto kushte nuk do të

³ DASIP-Bgd, Fondi MPB të Serbisë, F-XII, R/13, 1912. Komanda e Kështjellës së Beogradit nr. 4578, të 24.XI.1912.

⁴ AIHU-Bgd. Pop – II. K-13, F-1a. nr. 1/111, Stab Vrhovne Komande. Më gjerësisht shih: Dr. Liman Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Prishtinë 1986, 132-135.

⁵ AIHU-Bgd. Pop – II, K-13, f. 2 br. 2/4

pranoheshin nga shqiptarët gjenerali serb Bozhidar Janković kërcënohej se tërë pasuria dhe fshatrat kanë për t'u bombarduar.⁶

Këto kushte poshtëruese shqiptarët nuk mund t'i praninin dhe luftën në Lumë e vazhduan të ndihmuar edhe me përforcime të ardhura nga Dibra dhe vende të tjera të prira nga Elez Isufi, Isuf Xhelili, Xhafer Doda, Ramadan Zaskoci dhe Islam Spahiu. Mirëpo, forca ushtarake ishte në anën e ushtrisë serbe dhe kështu, sipas gazetës "Narodni list" të datës 14.12.1912 që botohej në Zarë, pas betejave të përgjakshme te Ura e Vezirit, Kulla e Lumës, Rrafshi i Lumës, në shpatijet e Xholicës, malit të Kolesianit e deri te Drini i Zi, nuk mbeti asnjë fshat pa u plaçkitur e djegur. Shkatërrimet dhe masakrat ishin aq të mëdha sa që në dokumentet ushtarake serbe dhe në gazetën e përmendur thuhej: "Luma nuk ekziston më".⁷ Për këto masakra dhe gjenocid ishte i njoftuar edhe Eduard Grej, i cili ia tërhoqi vërejtjen përfaqësuesit të Serbisë në Londër, por Pashiqi porosiste përfaqësuesit diplomatikë që t'i demantonin këto lajme.

Që nga 3 tetori e deri në fund të nëntorit 1912 ushtria serbe bashkë me forca të tjera ushtarake çetnike e paramilitare tentonte që sa më parë të dilte në bregdetin Adriatik për të okupuar sa më shumë tokë shqiptare. Një marshim i tillë hasi në rezistencë të forcave shqiptare, të popullit të vetorganizuar, si në Kosovë, Lumë, Has, Krasniqe dhe në fushat e Ploçut, të cilat mbironin vatrat e veta.⁸ Ushtria serbe më 26 nëntor pushtoi Krujë, më 27 Tiranë e më 28/29 Durrësin, duke dalë kështu në bregdetin shqiptar dhe duke realizuar synimin e saj shekullor. Ajo e dinte se ky pushtim nuk do të ishte i suksesshëm sikurse ai i vitit 1877/78. Megjithatë Serbia, Mali i Zi dhe Greqia pushtuan dhe mbajtën të pushtuara pjesën veriore të Shqipërisë, gjysmën e Sanxhakut. Serbia Kosovën dhe tokat shqiptare në gjysmën e Maqedonisë së sotme, kurse Greqia Çamërinë.

Në Maqedoni pas Shkupit pushtojnë Tetovën, Gostivarin, Kërçovën e pas Betejës së Manastirit komandës së ushtrisë serbe iu lirua krahu tjetër që të mund të drejtohej nga bregdeti shqiptar. Në këtë valë të luftës dhe fitoreve të shpejta ushtria serbe më 29 nëntor pushtoi Dibrën me anën e Divizionit të Moravës, formacioni rezerv⁹, që do të thotë një ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Për masakrat që bënte ushtria serbe gjatë depërtimit nëpër tokat shqiptare në shumë raste ka shkruar

⁶ Shih: Dr. Xheladin Shala, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918, Prishtinë, 1990 f. 64.

⁷ "Narodni List". 14.XII.1912, Zarë.

⁸ Shiko: Aleksandër Stojčević; Istorija naših ratova 1912-1918, Bgd. 1932, fq. 180-195.

⁹ Xh.Shala, v. c. fq. 70.

edhe shtypi serb, siç ishte ai i okupimit të Gjakovës, në afërsi të së cilës, pasi masakroi 72 veta, gra e fëmijë, i dogji për së gjalli në një shtëpi.¹⁰ Në raportet e tilla shtypi me cinizëm shkruante se si kullat shqiptare të zbrazëta po digjeshin më lehtë sesa ato të mbushura me njerëz.¹¹ Siç dihet, Gjakova ka qenë okupuar nga Serbia dhe Mali i Zi përnjëherë, kurse lumi Krena ka qenë kufiri ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë deri më 15.12.1913, kur ato merren vesh dhe i ndërrojnë territoret mes vete. Kështu, Mali i Zi merr Prijepolen, ndërsa Gjakovën Serbia. Kur ushtria malazeze niset drejt Shkodrës, kral Nikola urdhëroi organet ushtarake që para se të caktoheshin trupat, në pjesën e Dukagjinit dhe të Gjakovës të bënin një regjistrim të popullsisë, e cila sipas tyre kishte 71.939 veta nga të cilët vetëm 637 ishin të origjinës sllave.¹² Shqiptarët, edhe pse trojet e tyre pushtoheshin, nuk e ndalnin rezistencën dhe nuk pajtoheshin me një robëri të re. Për këtë dëshmon fakti se më 14-15 nëntor, kur ushtria serbe depërtoi në Lumë, në fshatin Bicaj kishte shkuar ato ditë Isa Boletini për të ndaluar kalimin e ushtrisë serbe mbi lumin Dri te fshati Spas.¹³ Ndërkaq, forcat militare të shtyra nga organet më të larta shtetërore dhe ushtarake vetëm sa i shtonin masat e represionit për arritjen e qëllimit makabër - shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre, dërgimin nëpër kampe përqendrimi. Për vrasjet e shumëta ishin të njoftuara organet ushtarake e shtetërore, sikur edhe opinioni i gjerë që për to mësonte nga shtypi. Kështu, për shembull, gazeta "Politika" e datës 14.11.1912 shkruante se për 15 ditë lufte, ndër sukseset e tjera është edhe shpërngulja e 70.000 shqiptarëve myslimanë nga Ballkani për në Turqi.¹⁴ Për shkak të të gjitha masave gjenocidale që ndërmernte soldateska serbe e ndihmuar edhe nga aleatët ballkanikë, ajo nuk ishte e qetë dhe pa viktima. Ndonëse kishte vendosur pushtetin ushtarak, për mbrojtjen e nëpunësve, por edhe të hekurudhës që kalonte nëpër Ferizaj, ushtria serbe kërkonte t'i dërgohej një batalion ushtarësh.¹⁵

Këtu nuk do të numërojmë të gjitha krimet dhe aktet gjenocidale, por po përmendim vetëm ca sosh për të vënë në dukje se pa marrë parasysh a iu bë rezistencë apo jo, ushtria serbe bëri masakra nëpër të gjitha vendet

¹⁰ Politika – Bgd. 3.XI.1912.

¹¹ AIHU, Bgd. pop. II – k. 104. f. 1. nr. 48.

¹² Xh. Shala, v. c. 62.

¹³ DASIP, P.O. viti 1912, tel. 4156, Kom. Armatës III serbe në Prizren, Kom. Arm III në Shkup.

¹⁴ Politika – Bgd. 14.XI.1912.

¹⁵ AIHU – Bgd. pop. II, k-49, f. 2, br. 11/10.

nga kaloi. Po theksojmë rastin e Tetovës, kur ushtria serbe, edhe pse nuk iu bë rezistencë, një natë tuboi dhe pushkatoi 85 shqiptarë në oborrin e teqes Arabati Babateqe, mblodhi 14 pendë që e buaj, plaçkiti jo vetëm Çarshinë, por edhe shtëpitë me radhë, duke dhunuar gra e vajza edhe 12 vjeçe, të cilat mëpastaj i pushkatonin. Pas shuarjes së Kryengritjes së shtatorit të vitit 1913, ushtria serbe dogji 16 fshatra të Gostivarit dhe pushkatoi me qindra njerëz.¹⁶

Shqiptarët asnjëherë nuk i pranuan rezultatet e Luftës së Parë Ballkanike dhe vendimet e paqes të Bukureshtit të 28 korrikut 1913, kur aleatëve ballkanikë definitivisht iu pranuan rezultatet e luftës. Menjëherë, siç kemi përmendur edhe më parë, filluan organizimin e rezistencës, iu kthyen forms tradiconale, luftës kaçake – guerile, deri te kryengritjet e përgjithshme. Se shqiptarët ishin në lëvizje vërtetojnë qindra raporte ushtarake serbe si në Kosovë ashtu edhe në pjesët e okupuara të Shqipërisë. Raportet ushtarake flasin se që në muajin shkurt 1913, kur paria shqiptare e Kosovës gjendej e internuar në Beograd, Isa Boletini në rrethinat e Kukësit u kishte shpërndarë 300 pushkë kosovarëve të strehuar në këto anë dhe që përgatisnin një kryengritje për çlirimin e viseve të okupuara. Serbia, duke dëshiruar që të ndikojë tek shqiptarët për të mos u ngritur në kryengritje ose të paktën të mësojë për planet dhe qëllimet e kryengritësve, dërgoi dy serbë të njohur, Bogdan Radenkoviçin dhe Vojislav Kovaçeviqin, të cilët ishin punëtorë të rryer nacionalë serbë. I dërgoi këta dy pasi që veglat e saj Prek Bibdoda dhe Marka Gjoni kishin humbur besimin tek shqiptarët,¹⁷ pra, ishin komprometuar. Në verën e vitit 1913 raportet që dërgonin dy serbët e përmendur vërtetonin se përgatitjet për kryengritje ishin në përfundim e sipër dhe se më aktivët në këtë punë ishin Isa Boletini, Elez Isufi, Bajram Curri, Riza bej Kryeziu, Shaqir e Mersi Dema, Isuf Xhelili, kurse Hasan Prishtina ishte në krye të kësaj kryengritjeje, por nuk dilte haptazi pasi që përgatitej për ta marrë postin e ministrit në Qeverinë e Vlorës. Sipas Kovaçeviqit dhe Radenkoviçit, ndër popullatën shqiptare përgatitej kryengritja dhe flitej se do ta bëjnë një revolucion, edhe pse shumica prej tyre nuk e kuptonin fjalën revolucion.¹⁸ Po ashtu, edhe në territorin e Kosovës hetohej një atmosferë e disponimit për luftë kundër okupatorit, i cili në çdo fshat kishte vendosur

¹⁶ Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje, ASHAK, Prishtinë, 1995, f. 91.

¹⁷ Xh. Shala, v. c. f. 152.

¹⁸ AIHU, Bgd, Pop. II, k-13, dok.1/55. etj.

patrulla ushtarake, njerëz të mobilizuar dhe të sjellur rishtaz nga Serbia. Shpallëshin për kaçakë të gjithë ata që në fshatrat e veta nuk shiheshin madje për dy ditë. Kështu, ta zëmë, territorin e komunës së tanishme të Mitrovicës e kishin ndarë në 13 komuna, ndërsa 585 meshkuj të këtyre fshatrave i kishin shpallur kaçakë.¹⁹ Qeveria serbe po ashtu formoi një komision shtetëror për ndjekjen e gjendjes në terren dhe të disponimit ndër shqiptarët në viset e okupuara. Në krye të këtij komisioni ishte dr. Jovan Haxhivasileviq, i cili po në verën e vitit 1913, në një raport dërguar Qeverisë në Beograd, lajmëronte: pushteti serb tek shqiptarët nuk ndihet fare, nuk duan të dinë për ligjet serbe. Lëvizja Kaçake vepron dhe forcohet për çdo ditë ngase populli e përkrah dhe e ushqen, se kryengritja antiserbe është në prag.²⁰ Në bazë të deklaratave të shumicës së prijësve të kryengritjes e të cilëve tani u ishin bashkangjitur edhe Sadik Rama-Gjurgjeviq dhe të tjerë, kryengritja ishte planifikuar të shpërthente diku nga gjysma e shtatorit, por ajo shpërtheu më herët dhe kështu forcat ushtarake serbe i zuri në befasi. Kryengritja shpërtheu në territorin e Dibërës së Vogël – Peshkopisë. Kryengritësit e çliruan pastaj Dibrën e Strugën dhe detyruan forcat ushtarake dhe paramilitare serbe të tërhiqeshin në drejtim të Kërçovës, Gostivarit dhe Tetovës. Kryengritësit shqiptarë çliruan Kërçovën e Gostivarin dhe iu drejtuan Tetovës, por pasi që nga Shkupi arritën përforcime të mëdha, më 26 shtator shqiptarët u detyruan të tërhiqen në drejtim të Gostivarit dhe Mavrovës. Forca të mëdha serbe shkonin pas kryengritësve shqiptarë, duke i thyer dhe detyruar të tërhiqeshin në drejtim të Dibërës.

Kryengritësit sulmuan në katër drejtime: 1. Ura e Arasit – Peshkopi – Dibër – Gostivar; 2. Qafë-Thanë – Strugë – Ohër – Resnjë; 3. Ujmisht – Bicaj – Vranishtë – Prizren; dhe 4. Krasniqe – Gash – Gjakovë.²¹ Në të gjitha drejtimet kryengritësit patën seksese në fillim, populli iu bashkangjiti pa dallim moshe. Sipas dokumenteve serbe, kryengritësit ishin shumë dobët të armatosur. Bile në shumicën e rasteve luftëtari priste deri sa t'i vritej shoku për ta marrë pushkën dhe për të vazhduar luftën, prandaj edhe u thyen. Po sipas raporteve të ushtrisë serbe, në këtë kryengritje morën pjesë aktive diku rreth 12.000 shqiptarë. Pas presionit të madh, kryengritësit u detyruan të tërhiqen në territorin e Shqipërisë Londineze e

¹⁹ AJ, Bgd. F. MPB, Ia, F-4 – r. 50, 1914.

²⁰ DASIP, Bgd. P.O. f. 1. dos. 3, 4.IX.1913.

²¹ Dr. Limon Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Prishtinë 1986, f. 160-161.

të tjerët në brendësi të territoreve të okupuara shqiptare, duke vazhduar rezistencën e armatosur të riorganizuar në çeta kaçake. Udhëheqës të drejtpërdrejtë të kryengritjes ishin Isa Boletini, Elez Isufi, Qazim Lika, Bajram Curri, Riza bej Kryeziu, Sadik Rama, Ramadan Zaskoci. Kryengritja nuk e pati përkrahjen e Qeverisë së Vlorës e as të qeverive të shteteve evropiane.²²

Përveç akteve gjenocidale që përmendëm më lart, Qeveria e Serbisë bëri edhe shpërnguljen e popllsisë myslimane – shqiptare nga trojet e saja etnike. Kështu, nga nëntori i vitit 1912 për në Turqi shpërnguli mbi 279.807 njerëz pa llogaritur fëmijët nën moshën 6 vjeçe.²³ Po ashtu, me shuarjen e Kryengritjes së vitit 1913 në rrethin e Gostivarit iu vu zjarri fshatrave Zdunë, Bitushë, Ravenë, Jellovicë, Tretë, Vërtok, Simnicë, Zhirovicë, Reçan, Orçushë, Tërnë, Dodaj, Tanushaj, Trebishtë, Padalishtë dhe Biteshtë. Në fshatin Qafë gratë me fëmijë u masakruan, kurse fshatit iu vu zjarri dhe mbi 300 burra po atë natë u dërguan në Gostivar dhe të gjithë u pushkatuan pa gjyq.²⁴ Këtij gjenocidi nuk mundën t'i shpëtojnë as qytetet e tjera shqiptare si Struga, Dibra, Peshkopia etj. sikurse edhe Durrësi, Tirana, Kruja e Lezha. Kështu e patën pësuar më 8 mars 1913 fshatrat e rrethinës së Durrësit: Zezë, Laruskë, Minikle, Scaj dhe Gramni. Në fshatin Zezë ushtria serbe kishte mbyllur në një shtëpi 20 gra e fëmijë dhe që të gjithë i kishte djegur për së gjalli.²⁵ Edhe përkundër krimeve e gjenocidit mbi të, popullsia shqiptare ishte e vendosur të luftojë për çlirimin dhe bashkimin me Shqipërinë Londineze ndonëse nuk e gëzoi përkrahjen e pritur pikërisht nga ata që lejuan një shkëputje të territoreve shqiptare, pra nga shtetet evropiane.

Kryengritja e vitit 1913, sipas burimeve ushtarake serbe dhe të tjera, ishte vetëm një provë e përgjithshme edhe për një kryengritje më të madhe në vitin pasues. Kështu, Lëvizja Kaçake me veprimet e saja nëpërmjet çetave as që e kishte ndalur veprimtarinë ushtarake, por tani e udhëzuar edhe nga Bajram Curri, Isa Boletini e Hasan Prishtina, jo vetëm se intensifikoi veprimtarinë e vet, por numri i luftëtarëve dhe i çetave shtoej për çdo ditë. Që në janar të vitit 1914 në horizont vërehej një atmosferë lufte. Sipas raporteve ushtarake serbe, nën udhëheqjen e

²² Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë 1978 fq. 440-445.

²³ Dokumenti o spoljnoi politici Srbije, 1903-1914, knj.VI. sf. I, Bgd. 1990, 345-360.

²⁴ AIHU, Bgd. Pop. III, K-81, fasc. 2, 12, nr. 56/1, të 19.X.1913.

²⁵ Leo Freundlich; Albaniens Golgatha, Anklageakten gegen die Vernichter der Albannervolkes, Wien. 1913.

Bajram Currit në Has ndodheshin afro 30.000 kosovarë e lumjanë, të cilët përgatiteshin për kryengritjen që do të shpërthente në pranverë. Që më 14 janar 1914 njoftohet qeveria në Beograd se për përgatitjen e kryengritjes në Kosovë shquheshin: në Vushtëri Zenel beu dhe Mulla Rifat Haxhihasani, kurse në rrethin e Prishtinës prifti nga Janjeva Nikollë Gllasniqi. Kjo frymë ishte e pranishme deri në Pazar të Ri dhe Sjenicë.²⁶ Në Prizren si prijës të kësaj kryengritjeje merreshin Musa Efendia dhe Isa Boletini. Në dokumentet ushtarake serbe thuhet se për këtë kryengritje kishin ardhur edhe shumë shqiptarë kosovarë të shpërngulur me dhunë më 1912-1913 (këta i quajnë herë emigrantë e herë muhaxhirë nga Kosova), në mesin e të cilëve ishin 25 prijës të njohur të cilët kishin zbritur në Portin e Durrësit. Këto lëvizje të kosovarëve Beogradit ia kishin ndezur dritat e alarmit. Përfaqësuesi i Serbisë në Durrës Panta Gavriloviq më 12.3.1914 lajmëronte Pashiqin se sipas porosisë së tij, kishte rënë në kontakt me Hasan Prishtinën nëpërmjet njerëzve të besuar të Serbisë dhe kishte fituar përshtypjen se "Hasan Prishtina është njeriu më i rrezikshëm për Serbinë, prej të gjithë kosovarëve, më inteligjenti dhe se të gjithë kosovarët sillen rreth tij".²⁷ Se kryengritja ishte në prag, në gjysmën e marsit të vitit 1914 e kishin hetuar edhe organet ushtarake serbe ngase për çdo ditë nga Shqipëria kalonin grupe të kosovarëve të armatosur dhe shkonin në rrethet e Prizrenit, Rahovecit dhe Therandës. Nga gjysma e marsit ishte caktuar të mbahej një tubim i madh i përfaqësuesve të viseve shqiptare. Këtij tubimi i patën paraprirë shumë tubime të vogla në të cilat zgjedheshin përfaqësuesit e atyre territoreve për në Kuvendin e Banjës së Malishevës. Sipas dokumenteve serbe, në këtë tubim kishin marrë pjesë mbi 600 veta, qoftë përfaqësues të çetave kaçake, qoftë edhe njerëz me autoritet në popull. Këtu si udhëheqës i kryengritjes na del Sadri Abazi nga fshati Kërvasari. Për pjesën veriore të Kosovës Zenel beu dhe Mulla Rifat Haxhihasani nga Vushtrria, nga rrafshi i Kosovës deri në Ferizaj prifti Nikollë Gllasniqi nga Janjeva, por udhëheqës dhe përgatitës ishin Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri e të tjerë. Sipas dokumenteve, kryengritja shpërtheu më 26 mars në rrethinat e Rahovecit, Therandës e Prizrenit. Me të shpejtë u krijua një zonë e lirë deri te Ura e Shenjtë. Serbia u alarmua shumë. Për shuarjen e kryengritjes angazhoi, përveç forcave ushtarake dhe xhandarmërisë, edhe njësitë çetnike, por thirrri në ndihmë edhe forca ushtarake malazeze nga Gjakova dhe njësitë e forma-

²⁶ Dr. Limon Rushiti, v.c. 162-163.

²⁷ DASIP-Bgd. P.O. f. 3, dos.3, dok.405 – 25.III.1914.

cioneve të posaçme të “Narodna Odbrana” – (Mbrotjtja Popullore). Megjithkëtë, kryengritësit çliruan Vushtrinë dhe dolën në terrenin e Drenicës, morën drejtimin për Pazar të Ri. Qëllim kishin çlirimin e trojeve shqiptare deri në Sjenicë.²⁸ Për shuarjen e kryengritjes, përveç forcave ushtarake e policore, Serbia angazhoi edhe mercenarët e vet me forcat e tyre si Esad Pashën, veglën e provuar Arif Hikmetin nga rrethina e Kumanovës, por ndihmë të madhe forcave të xhandarmërisë iu dha edhe punëtori politik shumëvjeçar i Serbisë me gjithë familje Dinë Arifi nga Sverka e Gashit (rrethina e Klinës), i cili shpëtoi 14 xhandarë në dhomën e grave. Kryengritja e Banjës u thye në prill. Ushtria serbe vetëm në rrethinën e Malishevës dogji 20 fshatra dhe bëri pushkatime në masë.²⁹ Kryengritja u shua, por populli shqiptar kurrë nuk u nënshtua. Esad Pasha atë vit, më 17 shtator 1914, në Nish u takua me Nikola Pashiqin dhe vërtetoi besnikërinë e tij ndaj Serbisë, të cilën sa herë ia kishte premtuar sekretari i tij Shahin bej Dino. Për këto shërbime Esadi mori para të mira nga Serbia, me të cilat edhe u bë kryetar i Qeverisë shqiptare.³⁰

Populli shqiptar dhe patriotët e mirëfilltë, edhe pse u shuan dy kryengritje- 1913 dhe 1914, për asnjë moment nuk e ndali luftën kundër okupatorëve në pjesët më të mira të Shqipërisë etnike. Hasan Prishtina, për t’i treguar edhe njëherë botës së lirë se populli shqiptar kërkon liri dhe bashkim, se asnjëherë nuk ishte pajtuar dhe nuk do të pajtohet me gjendjen e krijuar me Luftën e Parë Ballkanike, me shokët e idealit dhe me përkrahjen e popullit punoi dhe organizoi edhe kryengritjen e tretë, të cilën drejtpërdrejt e udhëheqi vetë dhe e cila shpërtheu më 12.2.1915 në Zhur dhe përnjëherë u përhap në vijën Qafë-Thanë deri në Malësinë e Gjakovës. Vetë Hasani më 13.2.1915 ishte në vijën e zjarrit si komandant në fshatrat Zapodë – Topojan – Gllaviçicë mbi Sharr (ish-Dragash) me ç’rast ushtria serbe që ndjekur gjer në Prizren.³¹ Edhe kjo kryengritje u shua, por populli shqiptar asnjëherë nuk u thye dhe luftën e vazhdoi deri në ditët kur UÇK-ja me ndihmën e NATO-s shporri ushtrinë dhe të gjitha forcat serbe nga Kosova.

²⁸ Po aty, dok. 841, 20.III.1914, nr. 716, 2141, 877, 28.III.1914, etj.

²⁹ Dr. Limon Rushiti, v.c. 159-169.

³⁰ Po aty, fq.186.

³¹ Po aty, f.171.

Dr. Liman Rushiti

THE RESISTANCE OF THE ALBANIAN PEOPLE
AGAINST SERB-MONENEGRIN OCCUPIERS BETWEEN 1912-1914

Summary

The Balkan allies, Serbia, Montenegro, Bulgaria and Greece realized in the First Balkan War their objective to drive out the Ottoman Empire from the Balkans, but also to extend their territories to the detriment of their neighbors' lands, particularly of Albanians and Macedonians.

Upon their entrance in Shkup (Skopje) the Serb Army captures at Breza of Karadak members of Albanian leadership, Nexhip Draga, Hasan Prishtina, Seit Efendia, Shaban Pasha, Kemajl Bey from Shkup, Hurshid Bey Prishtina, Muharrem Effendi Prishtina, Hurshid Bey Dobratini, Jashar Pasha from Peja, Ibrahim Kokola and Idriz & Kasum Seferi, taking them to the Belgrade prison and holding them there until 14 April 1914 after they sign loyalty statements.

During its penetration in Luma, on the second half of November 1912, the Serb Army using heavy artillery destroyed to the ground 27 villages. Apart from killings, massacres and destruction of villages the Army undertook a genocidal measure as well – that of forced deportation of the Albanian population. According to the Serb press of the time, around 70.000 Albanians had been deported to Turkey until 14 February 1912.